

VENDIM
Nr. 20, datë 13.12.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, të nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhërin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhërin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhërin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 20, datë 13.12.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e II, fashikulli nr. 140, “I çështjes veçantë mbi ndjekjen e veprimtarive armiqësore të komplotit M. Sh.”, me 2 volume, në total 545 (pesëqind e dyzet e pesë) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1981–1986. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

2. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, dosje fomulare nr. 34963, në ngarkim të S. Sh., me 2 volume, në total 381 (treqind e tetëdhjetë e një) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1981–1983. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

3. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, dosje fomulare nr. 34962, në ngarkim të V. Sh., me 292 (dyqind e nëntëdhjetë e dy) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1981–1983. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

4. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, dosje fomulare nr. 34964, në ngarkim të B. Sh., me 4 volume, me 982 (nëntëqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1981–1983. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

5. Arkivi i Autoritetit, Fondi nr. 4, dosje nr. 109, “Informacion i Drejtorisë së I për interesimin e diplomatëve të përfaqësive hungareze e bullgare, për gjendjen e F. Sh., dërguar KQ të PPSH-së të Kryeministrit”, me 3 (tre) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

6. Arkivi i Autoritetit, Fondi nr. 4, dosje nr. 306, “Për letrën e armikut B. Sh., dhe fotokopje përmbledhëse e saj”, me 6 (gjashtë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

7. Arkivi i Autoritetit, Fondi nr. 4, dosje nr. 313, “Mbi F. Sh., N. N. e M. Z.”, me 4 (katër) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1984. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

8. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, dosje fomulare nr. 34965, në ngarkim të M. Sh., me 4 volume, me 971 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1981–1986. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

9. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje fomulare nr. 6402, në ngarkim të M. Sh., me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

10. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Berat, dosje përpunimi nr. 2992, në ngarkim të B. Sh., me 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

11. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, dosje operative në ngarkim të M. Sh., me 18 volume, me 4156 (katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dokumentet datojnë në vitet 1981–1984. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Tepër sekret”.

II. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula